

DEKLARIM I TË DHËNAVE NË APLIKIMIN PËR VULLNETAR
Kërkohet nga Ligji i Shërbimit Mbrojtës të Fëmijëve
23 Pa. C.S. Section 6344.2 (lidhet me vullnetarët që kanë kontakt me fëmijët)

Unë dëshmoj/afirmoj se po kërkoj një pozicion vullnetari dhe **NUK** kërkohet të përftoj një certifikatë nga Byroja Federale e Investigimit (FBI), meqë:

- x Pozicioni ku po aplikoj është vullnetar dhe është pa pagesë; **dhe**
- x Unë kam qenë rezident i Pensilvanisë gjatë dhjetë viteve të fundit.

Unë e kam të qartë se në rast se unë nuk kam qenë rezident i Pensilvanisë gjatë gjithë dhjetë vite të fundit, por kam marrë certifikatë nga FBI me stabilizimin e vendbanimit, Unë mund të ofroj një kopje të kësaj certifikate të punëdhënësit e mi dhe nuk do të më kërkohet të marr ndonjë certifikatë tjetër shtesë nga FBI.

Unë dëshmoj/afirmoj se nëse ofroj certifikatën e marrë në periudhën e 60 muajve të fundit, Unë nuk kam qenë i skualifikuar nga shërbimet e nënvizuara më poshtë, ose nuk kam qenë i dënuar nga akuza të një natyre të ngjashme me krimet e shënuara më poshtë sipas ligjeve aktuale, ose ligjeve të mëparëshme të SH.B.A, ose të territoreve të saj, të Distriktit të Kolumbias, të Porto Rikos, ose të një shteti tjetër, ose sipas ligjeve të mëparëshme të këtij shteti.

Unë dëshmoj/afirmoj se nuk kam qenë autor krimi në ndonjë çështje që lidhet me abuzimin me fëmijët në 5 (pesë) vitet e shkuara, sipas përcaktimit të Ligjit të Shërbimeve Mbrojtëse të Fëmijëve.

Unë dëshmoj/afirmoj se nuk kam qenë i dënuar nga ndonjë prej krimeve të mëposhtëme, sipas Title 18 të statuteve të Pensilvanisë, ose nga krimeve me natyrë të ngjashme me këto krime sipas ligjeve aktuale, ose ligjeve të mëparëshme të SH.B.A, ose të territoreve të saj, të Distriktit të Kolumbias, të Porto Rikos, ose të një shteti tjetër, ose sipas ligjeve të mëparëshme të këtij shteti.

Kapitulli 25	(lidhet me vrasje kriminale)
Seksioni 2702	(lidhet me sulmet e rënda)
Seksioni 2709.1	(lidhet me gjymimin)
Seksioni 2901	(lidhet me rrëmbimin)
Seksioni 2902	(lidhet me mbajten e paligjëshme)
Seksioni 3121	(lidhet me përdhunimin)
Seksioni 3122.1	(lidhet me statutory sexual assault)
Seksioni 3123	(lidhet me mardhënie të devijuara seksuale të padëshiruara)
Seksioni 3124.1	(lidhet me sulem seksuale)
Seksioni 3125	(lidhet me incidente të rënda të pahijëshme)
Seksioni 3126	(lidhet me indecente të pahijëshme)
Seksioni 3127	(lidhet me ekspozime të pahijëshme)
Seksioni 4302	(lidhet me incestin)
Seksioni 4303	(lidhet me fshehjen e vdekjes së fëmijës)
Seksioni 4304	(lidhet me rrezikimin e mirëqenies së fëmijës)
Seksioni 4305	(lidhet me fëmijët e mitur)
Seksioni 5902(b)	(lidhet me prostitucionin dhe krime të ngjashme)
Seksioni 5903(c) (d)	(lidhet me materiale të turpëshme dhe materiale të tjera seksuale)
Seksioni 6301	(lidhet me korrupsionin e të miturve)
Seksioni 6312	(lidhet me abuzimin seksual të fëmijëve), ose një krim të ngjashëm sipas ligjeve të Shtetit dhe atyre Federale.

Unë dëshmoj/afirmoj se nuk kam qënë i dënuar për krime sipas Aktit 64-1972 (që lidhen me substanca të kontrolluara, paisje droge dhe akti kozmetik) gjatë pesë viteve të shkuara.

Unë e kam të qartë se nuk do të miratohem për shërbim, në rast se unë jam cilësuar si fajtor në një raport për abuzimin me fëmijët në pesë(5) vitet e fundit, ose kam qënë i dënuar për ndonjë prej krimeve të shënuara më lart, ose për krime me natyrë të ngjashme me këto krime, sipas ligjeve aktuale, ose ligjeve të mëparëshme të SH.B.A, ose të territoreve të saj, të Distriktit të Kolumbias, të Porto Rikos, ose të një shteti tjetër, ose sipas ligjeve të mëparëshme të këtij shteti

Unë e kam të qartë se në rast se unë jam arrestuar për, ose kam kryer një krim, i cili mund të përbëjë shkas për refuzimin tim në një program, aktivitet, ose shërbim, sipas Ligjit të Shërbimeve Mbrojtëse për Fëmijët, si më sipër, ose unë jam gjetur fajtor në një raport të gjetur apo të raportuar, Unë duhet t'i ofroj administratorit, ose të caktuarit prej tij një njoftim me shkrim, jo më vonë se 72 orë pas arrestimit, dënimit ose njoftimit, që unë jam shënuar si fajtor në listën e të dhënave që mbahen nga Shteti.

Unë e kam të qartë senë rast që personi përgjegjës për vendimin e punësimit, ose administratori i programit, aktivitetit, ose shërbimit, ka një dyshim të arsyeshëm se unë kam qënë i arrestuar, ose i dënuar për një krim që mund të përbëjë bazë për refuzimin e pjesëmarrjes në një program, aktivitet, ose shërbim sipas Ligjit të Shërbimeve Mbrojtëse të Fëmijëve, ose jam gjetur fajtor në një raport, ose kam paraqitur njoftim sipas kërkesave të këtij seksioni, personi përgjegjës për punësimin, ose administratori i programit, aktivitetit, ose shërbimit, do të kërkojë menjëherë që unë të paraqes çertifikatë aktuale nga Departamenti i Shërbimeve Njerëzore, Policia e Shtetit të Pensilvanisë dhe sipas rastit edhe nga FBI. Kostoja e çertifikatës do të përballohet nga njësia punësuese e programit, aktivitetit, ose shërbimit.

Unë e kam të qartë se fshehja e qëllimshme e informacionit të kërkuar më sipër përbën një keqbërje të shkallës së tretë dhe do të jetë subjekt i masave disiplinore, përfshirë refuzimin për pozicionin e vullnetarit.

Unë e kam të qartë se çertifikata e përftuar për qëllime të vullnetarizmit, mund të përdoret vetëm për këtë qëllim dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera punësimi.

Unë e kam të qartë se personit përgjegjës për vendimin e punësimit, ose administratorit të programit, aktivitetit, ose shërbimit, i kërkohet të mbajë një kopje të çertifikatave të mija.

Unë dëshmoj/afirmoj se informacioni i dhënë si më sipër, është i vërtetë dhe i saktë. Unë e kam të qartë se dëshmia e rreme është keqbërje dhe ndiqet sipas Seksionit 4903 të Kodit të Krimeve.

Emri: _____ Firma: _____

Dëshmitar: _____ Firma: _____

Data: _____